



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:126592

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 06003250

**P.nr.483/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal,** gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit B. Th me vendbanim në Pejë rr., G'' nr.... , për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Rrezikim i trafikut publik’’ nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.883/2021 të dt.21.7.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 16.06.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit te Prokurorisë Themelore ne Pejë, Ermal Demhasaj të pandehurit B. Th, mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Ardit Ibraj nga Peja, me dt.07.06.2024 publikisht shpalli , ndërsa me datë 05.07.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**B.TH,** nga i ati I dhe nëna N e gjinisë Sh i lindur me ..... në fsh..R K. Pejë, me vendbanim në Pejë rr., G'' nr...., ka të kryer shkollën....., ..... i ....., gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ..... të lëshuar nga MPB e R.Kosovës, me nr.tel ....., shqiptarë, shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse,**

Me datë ..... rreth orës ..... min, në rrugën,, K e B'' në Pejë ,nga pakujdesia shkel ligjin për rregullat e trafikut rrugor rrezikon jetën e njeriut me çka shkakton aksident trafiku i cili rezulton me lëndime të rënda trupore të dëmtuarit S. Th, në mënyrën që, gjersa i pandehuri ishte duke qarkulluar me automjetin e tij të markës „.....’’ me targa ..... në vendin e lartcekur në drejtim të Pejës, me të arritur në vendkalim dhe duke mos i dhënë përparësi kalimi, të njëjtin e godet në anën e majtë të pjesës së përparme të automjetit duke e hedhur në tokë, nga e cila goditje i dëmtuari pëson thyerje të multi fragmentare në kockën e shpatullës së majtë të klavikulës së majtë si dhe luksacionin në nyjën A/C të majtë.

-me çka ka kryer vepër penale „Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7,8, 38, 39, 40, 42, 47,48, 59, 69, 70, nenit 181 par.2,të KPRK-së, nenit, 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së nenit 364 dhe 365 të KPP-së, gjykata të pandehurit **B. Th** i shqipton

## **DËNIM ME KUSHT**

### **Ashtu që të njëjtit i përcakton:**

- I.** Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit prej **2 (dy) vitesh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** I pandehurit obligohet gjykatës t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor shumë prej **20 € (njëzetë euro) në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- III.** I pandehurit obligohet ta paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV.** Ndaj të pandehurit në kuptim të nenit 59 par.1 dhe par.2 nën per 1.6 e lidhur me nenin 65 të KPRK-së, i shqiptohet **DËNIM PLOTËSUES - MARRJA** e lejes së vozitjes për periudhën **2 (dy) vjeçare**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V.** I dëmtuari S. Th me vendbanim në Pejë Rr. „A.B” nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## *A r s y e t i m*

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjë PP/II.nr.883/2021 me datë 21.07.2021, kundër të pandehurit B. Th nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti seancë publike të shqyrtimit fillestar me datë 06.06.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit te Prokurorisë Themelore ne Pejë, Ermal Demhasaj të pandehurit të pandehurit B.Th, mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Ardit Ibraj nga

Peja, ndërsa mungonte i dëmtuari edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt për mbajtje të seancës, nuk prezanto dhe mungesën nuk e arsyetoi.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e udhëzuar për natyrën dhe pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, konform dispozitës së nenit 241 par.4 të KPPRK-së.

I pandehuri e vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, deklaroi se në mënyrë vullnetare ,pa presion e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë sipas aktakuzës, e pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Prokurori Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që i pandehuri e ka bërë në mënyrë vullnetare, me vetëdije të plotë pa presion dhe pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit u pajtua me pranimin e fajësisë të mbrojturit të tij për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës andaj i propozoi gjykatës të njëjtën ta aprovoj.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, e miratoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për vepër penale „Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat materiale nga aktakuza siç janë: procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit 2021-DR-226 dt.12.04.2021,raporti i aksidentit me dt.22.03.2021,deklarata e të pandehurit B.Th dt.22.03.2021 nl NJRKRR-Pejë, deklarata e të dëmtuarit S.Th e dhënë me datë 01.04.2021 në Pejë, , fletë lëshimi i QKUK i historisë 429, akt ekspertimi mjeko-ligjor me nr të ref.PE-271/21 dt. 05.06 2021,mendim i ekspertit të komunikacionit Blendi Parashumti i dt.28.05.2021, procesverbal për marrjen e deklaratës së të dëmtuarit S.Th dt.25.06.2021,procesverbal për marrjen e deklaratës së të pandehurit B.Th dt.15.07.2021 dhe shkresat tjera të lëndës.

Prokurori i shtetit lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin të merret parasysh pranimin e fajësisë ndërsa si rrethana rëndësuese të merren dënimet e mëparshme eventuale të të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i propozoi që si rrethanë lehtësuese për të mbrojturin e tij të merret parasysh deklarata e pranimit

të fajësisë, keqardhjen e tij për veprën e kryer nga pakujdesia në ditën kritike dhe kërkoj nga gjykata që në këtë rast ta aplikoj zbutjen e dënimit nën kufijtë e minimumit ligjor.

I pandehuri i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese për të, të merret parasysh pranimi i fajësisë dhe mosha e tij.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B.Th, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës „Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurës dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është e vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer nga pakujdesia.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, Si rrethana lehtësuese për të pandehurin morri parasysh pranimin e fajësisë, faktin se është .

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Ndaj të pandehurit në kuptim të nenit 59 par.1 dhe par.2 nën par.1.6 e lidhur me nenin 65 të KPRK-së, sipas propozimit të prokurorisë, i shqiptoi edhe dënim plotësues „ Marrja e lejes së vozitjes” dhe atë për periudhën 2 (dy) vjeçare, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e kjo me bindjen se ky dënim plotësues së bashku me dënimin kryesor do të ndikoj të i pandehuri për rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë që duhet të ketë si pjesëmarrës në komunikacion.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata palën e dëmtuar S.Th konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.483/2021, dt.05.07.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Gjyqtare e vetme gjykuese**

---

**Gylaj Nepola**

---

**Ilda Cucović Sahatçiu**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

**Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.**